



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:282563

Datë: 03.03.2025

Numri i dokumentit: 06993193

**P.nr.1035/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal**, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësor Dardan Tolaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit L. K. nga Peja , për shkak se ka kryer vepër penale „Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër” nga neni 332 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm nën shenjë PP.II nr.1987/2021, të dt.20.12.2021, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestar me datë 05.02.2025, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Pejë, Ermal Demhasaj, të pandehurit L. K. mori dhe publikisht shpalli po të njëjtën ditë, ndërsa me datë 03.03.2025, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri**

**L. K.**, me nr. personal ....., i lindur më ....., në Pejë, ku edhe banon ne lagjen P., banesat A., i biri i Sh. dhe nënës V. e vajzërisë S., ka te kryer shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, nr. tel....., shqiptar, shtetas i RKS-së.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse**, Me datë ..... në Pejë, në Rr” B. C. “ me qëllim të pengimit të realizimit të së drejtës pronësore, tjetëron sendin e tij, në të cilin personi tjetër ka të drejtën e pengut, dhe me këtë i shkakton dëm personit të tillë dhe atë bankës T.C.Z.t B. A.SH –Dega në Pejë, në atë mënyrë që i pandehuri në cilësi të debitorit kryesor në marrëdhënien kontraktuese, e lidhur në mes të dëmtuarës T.C.Z. B.A.SH –Dega në Kosovë, në njërën anë si kredi dhënëse, dhe” L. K.” B.I, si kredi marrës, garanton kredinë në vlerë prej 25,000 euro, me sendet e cekura si në marrëveshje mbi pengun me nr ..... e dt. 25.qershor e viti 2020, por meqenëse i pandehuri nuk i përmbahet dinamikës së kthimit të kredisë, gjatë vizitës së fundit në vend punimin e kompanisë me dt

08.09.2021 ,nga zyrtarët e të dëmtuarës, konstatohet se i pandehuri ka tjetërsuar kolateralin i lënë peng, ashtu që të dëmtuarës i ka shkaktuar dëme materiale në vlerë prej 25.700,00 euro.

- me çka ka kryer veprë penale “Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër” nga neni 332 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, ne bazë te nenit 7, 8 par. 1, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074), nenit 332 par. 1 të KPRK-së , nenit 450 dhe 452 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovë, të pandehurit i shqipton:

### **I. DËNIM ME BURGIM TË KUSHTEZUAR**

- II. në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen veprë tjetër penale brenda periudhës verifikuese **prej 1 ( një) viti**, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Obligohet i pandehura që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.
- IV. **URDHËROHET** I pandehuri që në emër të kërkesës pasurore juridike **PJESËRISHT** të bëjë kompensimin e dëmit dhe atë shumën në lartësi prej 25,700.00 (njëzet e pesë mijë e shtatëqind) euro të dëmtuarës Z. B. - Dega në Kosovë, të cilën shumë do të paguaj më këste dhe atë këstin mujor në lartësi prej (250) euro në muaj, duke filluar nga data 1 deri me datën 5 të çdo muaji vijues, gjer në pagesën definitive, e nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.
- V. Pala e dëmtuar Z. B.-Dega në Kosovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, për pjesën e mbetur të udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, me dt.20.12.2021 ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP.II nr.1987/2021, kundër të pandehurit L. K., për shkak të dyshimit të bazuar mirë së ka kryer veprën penale “Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër” nga neni 332 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 05.02.2025, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Pejë, Ermal Demhasaj, të pandehurit L. K..

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPPRK-së, e udhëzoi të pandehurin për të drejtat dhe detyrimet e tij.

Pas leximit të aktakuzës së lartcekur , gjyqtarja e vetme gjykues pasi është bindur se i pandehuri e kuptoi aktakuzën të njëjtit iu jap mundësia të pranoj ose të mos e pranoj fajësinë.

Në këtë rast pasi gjykata e ka udhëzuar të pandehurin për natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar udhëzimet e dhëna nga gjykata me ç ‘rast i njëjti, në mënyrë vullnetare dhe pa kurrfarë presioni e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë sipas aktakuzës.

Prokurori i shtetit nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë, pasi qe i pandehuri e bëri në mënyrë vullnetare, me vetëdije të plotë, e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë dhe ka mbështetje në shkresat e lëndës.

Gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, pas dëgjimit të palëve të cilën u pajtuan me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, e ka miratuar pranimin e fajësisë pasi është bindur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2 të KPPRK-së, pasi që e pandehura e kuptoj natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtjen, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: Marrëveshja e Kredisë me nr..... e dt. 25.06.2020;Marrëveshja mbi Pengun me nr. .... e dt. 25.06.2020; Lista e pengut të luajtshëm e dt.25.06.2020;Konfirmimi i regjistrimit të pengut Nr. R-20200629-50.Deklarata e të dëmtuarës Z. B. e pranuar në këtë Prokurori me dt 05.11.2021 e përpiluar nga menaxheri i degës në Pejë F. S. me nr të ID.1..... ; Deklarata e të dëmtuarës Z. B.e pranuar në këtë Prokurori me dt 05.11.2021 e përpiluar nga menaxheri i degës në Pejë, Sh. M. me nr të ID.....;

Prokurori i Shtetit deklaroi se në kontest të rrethanave lehtësuese të merret parasysh pranimi i fajësisë, kurse si rrethane renduese dënimet eventuale të mëparshme të të pandehurit.

Pala e dëmtuar përmes të autorizuarës së tyre përmes parashtresës së dt.03.02.2025 kanë deklaruar se i bashkëngjiten ndjekjen penale dhe se paraqesin kërkesë pasurore juridike ku kanë precizuar borxhin total në shumë totale prej 28,938.95€.

I pandehuri deklaroi se si rrethanë lehtësuese te merret pranimi i fajësisë.

Prandaj, me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e

të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të “Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332, paragrafi,1 të KPRK-së,

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka kryer veprën me dashje, pasi që ka qenë i vetëdijshme për pasojat e veprimeve të tij dhe ka dëshiruar realizimin e tyre, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurin, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjëse.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjyqtarja e vetme gjykuese konform dispozitave ligjore të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese morri pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethanë tjetër lehtësuese morri faktin së më parë nuk ka ra ndesh me ligjin. Rrethanat rënduese gjykata në rastin konkret për të pandehurin nuk gjeti.

Gjykata vlerësoi se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit do të arrihet të realizohet në tërësi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit . Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej një vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënim me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e morri konform nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, nenin 450, 452 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Pala e dëmtuar përmes parashtrësës së datës 06.02.2025, kanë precizuar kërkesën e tyre duke kërkuar vlerën e dëmit në lartësi prej 28,938.95 euro, me arsyetim si borxh i mbledhur. Mirëpo, meqenëse gjykatës nuk i është bashkangjitur asnjë provë e cila do të mbështeste kërkesën e tillë, lidhur me diferencën në lartësinë e dëmit nga lartësia e cila është e përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, gjykata të njëjtën nuk e aprovoi, pasi gjeti prova të cilat mbështesin vlerën e dëmit, shumë në lartësi prej 25,700.00 euro, siç është e përshkruar në gjendjen faktike e të cilën i pandehuri e pranoi. Andaj gjykata kërkesën e tillë e pranoi pjesërisht duke e obliguar të pandehurin të paguaj më këste dhe atë këstin mujor në shumë prej (250) euro në muaj, palës së dëmtuar Z. Banka, duke filluar nga data 1 deri me datën 5 të çdo muaji vijues, gjer në pagesën definitive, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Gjykata palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike, për pjesën e mbetur, e udhëzoi në kontest juridiko civil, konform nenit 462 par.2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**Divizioni Penal**  
**P.nr.1035/21, me datë 03.03.2025**

**Praktikanti gjyqësor**

**Gjyqtare e vetme gjykuese**

---

**Dardan Tolaj**

---

**Ilda Cucović Sahatçiu**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.